



Republika e Kosovës

Republika Kosovo/Republic of Kosovo

Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality



Kryetari i Komunës

02Nr. 400/- 31955/23
Dt. 29.11.2023

Duke u bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) Nr. 28/ 2008, neni 57, të Statutit të Komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për ndarjen e Subvencioneve Komunale 01.Nr.060/01-31587/1 të datës 24.12.2020, gjithashtu, marrë parasysh se shumica e mjeteve të zotuar për ndarjen e subvencioneve, tejkalon shumën nga ajo që është cekur në konkurs, e me qëllim të lehtësimit të shkollimit të studenteve të komunës tonë, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

- I. **TË LEJOHEN** mjetet në shumën prej 450.00€ për secilin përfitues nga Komuniteti Shqiptar dhe nga 550.00€ për secilin përfitues Komunitetet jo shumicë.
- II. Rritja e shumës së përfituesve bëhet për arsye se sipas konkursit për ndarjen e bursave për studentët e komunës së Dragashit me nr. të protokollit 13/1103 të dt. 12.10.2023 janë paraparë 350€ për secilin student, mirëpo pasi që nuk është plotësuar numri i parashikuar, dhe ka mjete në dispozicion për këtë qëllim atëherë u vendos si në pikën I të këtij vendimi.
- III. Këto mjete të lejohen nga pozicioni buxhetor për Subvencione nga Drejtoria Komunale për Arsim.
- IV. Për implementimin e Vendimit **OBLIGOHET** Drejtoria Komunale e Arsimit.
- V. Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit nga kryetari i Komunës .

Vendimi u Dërgohet :

- Drejtorisë së Arsimit,
- Zyrës së Personelit
- Arkivës së Kryetarit

Kryetari i Komunës

Dr. **Bexhet XHELADINI**

